

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2026.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR , PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E
ANKIMIMIT

Data 26.08.2026

Drejtuar: Operatorit Ekonomik (OE): GE.CO SHPK me NIPT K41416035I

Adresë: Tirane Tirane TIRANE Rruga Sabaudin Gabrani, tek ish SMT.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur, Mbi Kufirin e larte Monetar ,Mall

Numri i referencës së procedurës: REF-88454-06-02-2026

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje materiale ndihmëse për prodhim dhe shtrim asfalti”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

Aditivë kimike 24957000-7

Fondi limit: 24,144,000 (njetzet e kater milion e njeqind e dyzet e kater mije) leke pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjete) muaj nga lidhja e draft-marrëveshjes

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 03.06.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike Nr. 37 datë 8 Qershor 2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik AMOS OIL SHA me NIPT K87508801F

Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 17,014,000 (shtatëmbëdhjetë milion e katërmbëdhjetë mijë) Lekë.

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 20,416,800 (njëzet milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind) Lekë

2. Operatori Ekonomike GE.CO SHPK me NIPT K41416035I

Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 17,335,000 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë) Lekë;

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 20,802,000 (njëzet milion e tetëqind e dy mijë) Lekë.

3. Operatori Ekonomike TRIOS SH.A me NIPT L12805203J.

Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 18,108,000 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e tetë mijë) Lekë;

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 21,729,600 (njëzet e një milion e shtatëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind) Lekë.

4. Operatori Ekonomike RESULI - ER sh.a me NIPT L12510413V

Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 0 (zero) Lekë;

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 0 (zero) Lekë;

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik AMOS OIL SHA me NIPT K87508801F

Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 17,014,000 (shtatëmbëdhjetë milion e katërmbëdhjetë mijë) Lekë.

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 20,416,800 (njëzet milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind) Lekë

K.V.O në datë 06.08.2026 në zbatim të nenit 26, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë: rruga “5 Maji”, Tiranë ka njoftuar Operatorin Ekonomike “AMOS OIL” sha , me NUIS K87508801F te dorëzojë pranë Zyrës së Protokollit të kësaj Drejtorie, brenda pesë ditëve dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit të sipërpërmendur, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike për procedurën e prokurimit me numër me REF -88454-06-02-2026 me objekt “Blerje materiale ndihmëse për prodhim dhe shtrim asfalti

KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “AMOS OIL” SHA, në kuadër të procedurës së prokurimit, nga ku rezultoi se në Shtojcën 9 – Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, operatori ekonomik ka deklaruar se disponon mjetin

Autobitumatrice me kapacitet jo më pak se 2,000 litra për lëvrimin e prajmerit, me targë AB245AL dhe numër shasie WMAL84ZZ05Y141872.

Në Dokumentet Standarde të Tenderit, në kërkesat për mjetet dhe pajisjet teknike, është përcaktuar shprehimisht se: pika c) “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të dallohet qartë marka dhe targa e mjetit.”

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik pranë Autoritetit Kontraktor, rezulton se për mjetin Autobitumatrice, me targë AB245AL, janë paraqitur dokumentet e kërkuara që lidhen me regjistrimin dhe përdorimin e mjetit, por nuk është paraqitur fotografia e mjetit, në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar shprehimisht në pikën c) të kërkesave të DST-së.

Kërkesa për paraqitjen e fotografisë për secilin mjet të deklaruar nuk është një kërkesë fakultative, por një kërkesë, e cila duhet të përmbushet nga operatorët ekonomikë në mënyrë të plotë dhe në përputhje me dokumentet e procedurës, ku të dallohet qartë marka dhe targa e mjetit, pasi mungesa e fotove nuk i mundëson Autoritetit Kontraktor verifikimin e plotë të përputhshmërisë së mjetit të deklaruar me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në këto kushte, pavarësisht faktit se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e regjistrimit, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin dhe dokumentacionin tjetër të kërkuar për mjetin, mungesa e fotografisë së mjetit, e kërkuar shprehimisht në pikën c) të DST-së, **përbën mospërmbushje të kërkesave të kualifikimit..**

2. Operatori Ekonomike RESULI - ER sh.a me NIPT L12510413V

Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 0 (zero) Lekë;

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 0 (zero) Lekë;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga operatorit ekonomik RESULI - ER sh.a dhe pas verifikimit të tij rezulton se:

OE nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor dhe teknik sipas kërkesave të përcaktuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, si dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Sa më sipër, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e operatorit ekonomik RESULI - ER sh.a nuk është në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit, për rrjedhojë **skualifikohet.**

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatori ekonomikë i mëposhtëm është identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. Operatori Ekonomike GE.CO SHPK me NIPT K41416035I

Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 17,335,000 (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë) Lekë;

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 20,802,000 (njëzet milion e tetëqind e dy mijë) Lekë

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR